

NJOFTIM PËR MARRJE AMBIENTI ME QERA PËR ZYRAT E NJËSISË ADMINISTRATIVE SUKTH

Bazuar në urdhërin me nr. 105, datë 27.03.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për përzgjedhjen e ambientit privat që do të merret me qira nga ana e Bashkisë Durrës për t’u përdorur si zyra për Njësinë Administrative Sukth”, në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr. 8561, datë 22.11.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar dhe Shkresës së Njësisë Administrative Sukth me nr. 97 prot, datë 11.03.2026 protokolluar me tonën nr. 3767 prot., datë 17.03.2026.

Për sa më lart grupi i punës, duke marrë parasysh numrin e punonjësve dhe detyrat funksionale që do të kryhen në këto ambiente, vlerësoi që pasuria që kërkohet të merret me qira të përmbush këto kritere:

- Të jetë e përshtatshme dhe të përmbajë sipërfaqen e nevojshme për zyra të cilat do të përdoren për; zyrën e administratorit dhe inspektorëve, zyrën e administratorit të ndihmës dhe përkrahjes sociale, zyrën e gjëndjes civile.
- Të ketë një ambient për pritjen e qytetarëve.
- Ambienti që do të merret me qira të jetë brenda territorit të Njësisë Administrative Sukth.
- Të ketë një sipërfaqe minimale 200 m².
- Afati i dorëzimit të ofertave është 15 ditë mbas publikimit në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

Dokumentacioni që do të paraqesin konkurentët janë:

- Kërkesa për dhënien me qira ku do të deklarohet **oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë dhe në total.**
- Kartën e identitetit.
- Dokumentin e pronësisë të njehsuar me origjinalin.
- Përshkrimi i detajuar i objektit që do të jepet me qira dhe gjendia fizike e ambientit.
- Deklarata e qiradhënësit ku deklarohet se ndaj objektit nuk është vendosur sekuestro e çdo lloji.
- Vertetim nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka proces gjyqësor.
- Dokumenta që vërtetojnë se ambienti është i paisur me matësa të veçantë të matjes së energjisë elektrike dhe të ujit.
- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar.

Paraqitja e dokumentacionit do të kryhet pranë Bashkisë Durrës, në kati i parë, në zyrat e Marëdhënieve me Publikun, me datë 16/04/2026 dhe datë 17/04/2026.

Duke Ju falenderuar,